

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo		
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		
CAA		
Nr. i prot. 2023/ZDP/203		
Br. prot./Print Nr.		
Faqe: 2	Kopje: -	Datë: 07.06.2023
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date
Hyrës/ulazno/in.....	<input type="checkbox"/>	
Dalës/izlazno/out.....	<input checked="" type="checkbox"/>	
Brendshëm/vinternë/internal.....	<input type="checkbox"/>	
Prishtinë/Priština/Pristina		

05/ZDP/VE/2023

Datë: 07 qershor 2023

Në mbështetje të nenit 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019), në pajtim me Shtojcën I pika ATCO.A.020, Shtojcën II pika ATCO.AR.A.010 (a) (1), Shtojcën IV pikat MED.B.070 dhe ATCO.MED.A.046 të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror,

Duke marrë për bazë Rekomandimin e drejtorit të nga Departamenti të Shërbimit të Navigimit Ajror,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. **REVOKOHET** licenca e Kontrollorit të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror, me numër të licencës CAA033 së bashku me të gjitha gradimet dhe miratimet.
2. **OBLIGOHET** departamenti i Shërbimeve të Navigimit Ajror të marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me zbatim të këtij Vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi më ditën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri në marrjen e një Vendimi tjetër nga Drejtori i Përgjithshëm.

Arsyetim

Gjatë ekzaminimit të rregullt aero-mjekësor të kryer më 22.02.2023 në Qendrën Aero-Mjekësore në Gjakovë, me qëllim të vazhdimin të vlefshmërisë së certifikatës mjekësore të klasës 3 dhe ekzaminimit shtesë më dt. 17.03.2023, për kontrollorin e trafikut ajror me nr. të licencës CAA033, është konstatuar gjendja shëndetësore e cila mund të bije ndesh me dispozitat e pikën MED.B.070 të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Duke marrë parasysh këtë, Vlerësuesi i Autorizuar Mjekësor në AAC nxjerri Vendimin me nr. prot. 2023/DSF/AMS/GEN/99 më dt. 29.03.2023, përmes së cilit për shkak të avancimit të çrregullimit të gjendjes



shëndetësore, njoftohet kontrollori në fjalë, që i pezullohet përkohësisht e drejta e ushtrimit të privilegjeve që dalin nga posedimi certifikatës mjekësore të klasës 3 të kontrollorit të trafikut ajror.

Si rrjedhojë e kësaj drejtori i Departamentit SHNA ka rekomanduar revokimin e licencës me nr. CAA 033 me të gjitha gradimet dhe miratimet për shkak të gjendjes shëndetësore.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, me Shtojcën I pika ATCO.A.020, Shtojcën II pika ATCO.AR.A.010 (a) (1), Shtojcën IV pikat MED.B.070 dhe ATCO.MED.A.046. të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, dhe Rekomandimin e drejtorit të nga Departamenti të Shërbimit të Navigimit Ajror, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.



Iu dërgohet:

- Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Departamenti i Shërbimeve të Navigimit Ajror; dhe
- Arkivit të AAC-së.